

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXVI, nr. 8307
E shtunë, 23 maj 2026
Çmimi 0.50 €

KQZ-ja certifikon listën,
15,884 votues më shumë se
në zgjedhjet e fundit | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

NË PRAG TË ZGJEDHJEVE TË 7 QERSHORIT, QEVERIA NË DETYRË NDAN MJETE
FINANCIARE PËR DISA KATEGORI

OPOZITA DHE SHOQËRIA CIVILE THONË SE KURTI PO BLEN VOTA

FAQE 4-5



Qeveria në detyrë ka marrë vendim të ndajë nga 100 euro për fëmijët, pensionistët, studentët aktivë dhe punëtorët në sektorët privatë. Mbështetja prej 100 eurosh për pension-

istët dhe fëmijët do të ekzekutohet në fillim të javës së ardhshme, ndërkaq për studentët dhe punëtorët e sektorit privat pritet të hapet aplikimi javën e ardhshme.

Mbështetja prej 100 eurosh për punëtorët e sektorit privat dhe atë publik e që nuk paguhen nga buxheti i shtetit vlen për ata punëtorë me të ardhura mujore më pak se 1 000 euro

AKTUALE



Ç'ËSHTË TREGU I PËRBASHKËT
EVROPIAN DHE A MUND T'I
BASHKOHET KOSOVA? F. 3

PYETET NËSE DO TË HUMBASË NË
ZGJEDHJET E NËNTORIT, TRUMP:
NUK E DI, VËRTET NUK E DI F. 2

PROTESTOHET KUNDËR NDALIMIT
TË SHËRBIMEVE NDËRTIMORE NË
RUGOVË F. 3

EKONOMI



OEK-u HAP ZYRËN E PARË TË
DIASPORËS NË SHTUTGART F. 3

VENDIMI I QEVERISË HAP
RRUGËN PËR ZONËN
INDUSTRIALE NË GJAKOVË F. 8

SPORT




DUKAG-JINI FITON PËR HERË TË
PARË KUPËN E KOSOVËS F. 11



PËRKUJTOHEN
TË RËNËT NË
MASAKRËN E
DUBRAVËS:
SHTETI SERB
VEPROI SI
APARAT VRASËS

F. 5

KURTI ZHVILLOI TAKIM VIRTUAL
ME KATËR KONGRESISTË
AMERIKANË, DISKUTOHET PËR
REZOLUTËN PËR ANËTARËSIMIN
E KOSOVËS NË NATO F. 3



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

PYETET NËSE DO TË HUMBASË NË ZGJEDHJET E NËNTORIT, TRUMP: NUK E DI, VËRTET NUK E DI

WASHINGTON, 22 MAJ- Presidenti amerikan, Donald Trump është pyetur nga gazetarët nëse republikanët e Senatit po e humbin kontrollin e dhomës së lartë të Kongresit. Në përgjigjen e tij, Trump u tregua i paqartë për situatën politike dhe shmangu një vlerësim të drejtpërdrejtë mbi fuqinë e partisë së tij në Senat. “Nuk e di. Vërtet nuk e di. Unë

bëj vetëm atë që është e drejtë”, tha Trump, duke iu përgjigjur shkurt pyetjes së reporterit. Deklarata vjen në një moment kur vëmendja politike në SHBA po zhvendoset gradualisht drejt zgjedhjeve afatmesme (midterm elections), të cilat do të mbahen në nëntor të vitit 2026, konkretisht më 3 nëntor 2026. Këto zgjedhje janë vendimtare



për balancën e pushtetit në Kongres, pasi përcaktojnë kontrollin e Dhomës së Përfaqësuesve dhe një pjesë të Senatit, duke ndikuar drejtpërdrejt në aftësinë e presidentit për të çuar përpara agjendën e tij politike në pjesën e dytë të mandatit. Ndryshe, partia e drejtuar nga lideri amerikan ka kontrollin në Kongresin amerikan dhe Senat.

ZELENSKY PARALAJMËRON: RREZIKU I VITIT 2022 MBETET ENDE REAL

KIEV, 22 MAJ - Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, ka paralajmëruar se vendi i tij vazhdon të përballet me kërcënime serioze të ngjashme me ato të fillimit të pushtimit rus në vitin 2022. Në një takim me udhëheqës lokalë në Kiev dhe Çernihiv, ai deklaroi se “Ukraina nuk mund të lejojë përsëritjen, qoftë edhe pjesërisht, të rreziqeve me të cilat u përball populli ynë në shkurt të vitit 2022”. Lideri ukrainas theksoi se



kërcënimi që ekzistonte në fillim të luftës “është po aq i pranishëm edhe sot”, duke u bërë thirrje qytetarëve dhe institucioneve të ruajnë vigjilencën dhe qëndrueshmërinë, shkruan skynews. Rajonet e Kievit dhe Çernihivit ishin ndër zonat e para të goditura gjatë ofensivës ruse, kur trupat e Moskës hynë në Ukrainë nga territori i Bjellorusisë me synimin për të marrë kryeqytetin ukrainas.

Një ditë më parë, Zelensky paralajmëroi se Rusia mund të përgatisë një ofensivë të re në veri të Ukrainës, e cila sipas tij mund të nisë sërish nga Bjellorusia. Në fjalimin e tij të natës, presidenti ukrainas tha se vendi po përgatitet për një skenar të tillë dhe dërgoi një mesazh të fortë drejt Moskës. “Ata duhet ta kuptojnë: do të ketë pasoja për ta dhe ato do të jenë të mëdha”, deklaroi Zelensky.

KTHESË E RE NGA TRUMPI, NJOFTON DISLOKIMIN E 5000 TRUPAVE AMERIKANE NË POLONI

WASHINGTON, 22 MAJ- Presidenti amerikan, Donald Trump, njoftoi se SHBA-ja do të dërgojë 5000 trupa shtesë në Poloni, vetëm shtatë ditë pasi Pentagoni anuloi dislokimin e planifikuar më herët të 4000 ushtarëve. Trump, përmes rrjetit Truth Social, tha se vendimi është marrë për shkak të marrëdhënieve të tij me presidentin polak Karol Nawrocki, të cilin e kishte mbështetur gjatë zgjedhjeve

presidenciale të vitit të kaluar. Ai nuk sqaroi nëse bëhet fjalë për të njëjtin kontingjent të planifikuar më herët apo për një operacion krejtësisht të ri. Shtëpia e Bardhë javët e fundit kishte sinjalizuar se synon të zvogëlojë praninë ushtarake amerikane në Evropë në kuadër të politikës “America First”. Më herët këtë muaj, Uashingtoni paralajmëroi edhe tërheqjen e 5000 ushtarëve nga Gjermania pas përplasjeve mes



Trumpit dhe kancelarit gjerman Friedrich Merz lidhur me luftën ndaj Iranit. Ende nuk është e qartë nëse trupat që do të dërgohen në Poloni do të jenë pjesë e

forcave që po tërhiqen nga Gjermania apo do të vijnë nga njësi të tjera amerikane. Trump më herët kishte kritikuar aleatët e NATO-s, duke akuzuar se nuk po marrin barrë më të madhe në përballjen me Iranin dhe tensionet rreth Ngushticës së Hormuzit. Ministrat e Jashtëm të vendeve të NATO-s pritët të takohen në Suedi, ku do të marrë pjesë edhe Sekretari amerikan i Shtetit, Marco Rubio. Sipas pritjeve, ai do të kërkojë që

partnerët evropianë të marrin më shumë përgjegjësi brenda aleancës. Njoftimi i Trumpit vjen vetëm një javë pasi Departamenti amerikan i Luftës kishte pezulluar papritur dërgimin e 4000 ushtarëve në Poloni. Sekretari i Mbrojtjes, Pete Hegseth, më pas deklaroi se bëhej fjalë vetëm për një “shtyrje të përkohshme” dhe se SHBA-ja do të vazhdojë të ruajë një prani të fortë ushtarake në Poloni.

Merkeli nuk do të ndërmjetësojë mes BE-së dhe Rusisë

BLERIN, 22 MAJ - Angela Merkel ka hedhur poshtë idenë se mund të luajë rol ndërmjetësues mes Bashkimit Evropian dhe Rusisë, duke argumentuar se situata aktuale gjeopolitike kërkon aktorë me peshë të drejtpërdrejtë politike dhe institucionale. Sipas saj, presidenti rus Vladimir Putin i merr seriozisht vetëm ata liderë që kanë fuqi reale vendimmarrëse dhe ndikim të drejtpërdrejtë në politikën ndërkombëtare.

Kjo, sipas ish-kancelarit gjerman, e bën të vështirë çdo përpjekje individuale për ndërmjetësim që nuk mbështetet nga struktura të forta shtetërore apo nga një mandat i qartë diplomatik. Merkel theksoi gjithashtu se, në këndvështrimin e saj, Evropa nuk po e shfrytëzon plotësisht potencialin e saj diplomatik. Ajo shprehu keqardhje që Bashkimi Evropian shpesh nuk vepron me një zë të unifikuar

në çështjet e mëdha ndërkombëtare, gjë që, sipas saj, e dobëson ndikimin e kontinentit në raport me fuqitë e tjera globale. Deklaratat e saj janë interpretuar si një kritikë ndaj mënyrës se si Evropa ka menaxhuar marrëdhëniet me Rusinë pas përshkallëzimeve të fundit të tensioneve, duke theksuar nevojën për koordinim më të fortë dhe strategji më të qarta diplomatike.



Protestohet kundër ndalimit të shërbimeve ndërtimore në Rugovë

Prishtinë, 22 maj- Banorë nga Rugova e Pejës kanë protestuar të premten para objektit të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në shenjë kundërshtimi ndaj vendimit për pezullimin e mallrave dhe shërbimeve ndërtimore në Rugovë.

Protesta është organizuar nën moton "Rugova nuk hesht - Rugova kërkon drejtësi!". Protestuesit kanë mbajtur në duar pankarta në duar "Stop padrejtësive ndaj trevës së Rugovës", "Zhvillimi nuk është

krim", "Rugova jashtë parkut", e të tjera. Pas protestës para objektit të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, protestuesit kanë protestuar edhe te objekti i qeverisë.

Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se qëndron në mbështetje të plotë të kërkesave të drejta të banorëve të Rugovës, të cilët me të drejtë po kundërshtojnë vendimin absurd për ndalimin e transportit të materialit ndërtimor në Bjeshkët e Nemuna. "Nuk mund të

mbrohet natyra duke dënuar njerëzit që jetojnë aty brez pas brezi, duke ua pamundësuar ndërtimin e shtëpive, zhvillimin e bizneseve familjare dhe përmirësimin e kushteve të jetesës. Rugova nuk është një zonë e zbrazët në hartë. Është një trevë e gjallë, me 13 fshatra, me familje punëtore që jetojnë çdo ditë me sfidat e mungesës së infrastrukturës dhe kërkojnë vetëm mundësinë për të zhvilluar pronën dhe jetën e tyre", ka thënë Haradinaj.



KURTI ZHVILLOI TAKIM VIRTUAL ME KATËR KONGRESISTË AMERIKANË, DISKUTOHET PËR REZOLUTËN PËR ANËTARËSIMIN E KOSOVËS NË NATO

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 22 MAJ - Kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, zhvilloi një takim virtual me kongresistët amerikanë Keith Self, Ritchie Torres, Mike Lawler dhe George Latimer, të cilët javë më parë paraqitën dy rezoluta të rëndësishme për Kosovën në Dhomën e Përfaqësuesve në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Krahas falënderimeve për mbështetjen e vazhdueshme dhe të palëkundur të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Kryeministri në detyrë Kurti u shpreh i atyre mirënjohje të thellë për Rezolutën nr. 1246, e cila mbështet aspiratat e Republikës së Kosovës për t'u bërë pjesë e Aleancës Veri-Atlantike, dhe Rezolutën nr. 1250, e cila bën thirrje që forcat amerikane të vazhdojnë të kontribuojnë në kuadër të KFOR-it.

Kryeministri në detyrë Kurti theksoi se qëndrimi i NATO-s në Kosovë dhe anëtarësimi i Kosovës në NATO janë prioritetet kyçe për Qeverinë, duke shtuar se ato janë thelbësore për sigurinë në rajon. Në këtë kontekst ai veçoi thirrjen e kongresistëve që katër shtetet jo-njohëse



anëtare të aleancës që ta njohin Republikën e Kosovës, duke ia hapur derën vendit tonë që të anëtarësohet në NATO.

Duke theksuar se do të ishte një rritje e jashtëzakonshme e sigurisë rajonale, por edhe në interesin strategjik të SHBA-së dhe NATO-s, kryeministri në detyrë Kurti e ritheksoi qëndrimin e Qeverisë së Kosovës, që Bondsteel të bëhet

bazë e përhershme e ushtrisë amerikane.

Ai i informoi kongresistët se këtë javë Qeveria ka bërë hapin fillestar për krijimin e Xhandarmërisë, ndërsa theksoi se qëllimi i saj është të ndihmojë në përmbushjen e synimeve të sigurisë kombëtare, si p.sh. luftimi i kontrabandës dhe terrorizmit, e po ashtu ruajtja e

infrastrukturës kritike.

Kryeministri në detyrë Kurti theksoi se Xhandarmëria nuk është menduar si zëvendësim i KFOR-it, por si bashkëpunëtorë e afërt me të.

Duke përmendur se Marrëveshja Kornizë për Bashkëpunim në Mbrojtje me Departamentin e Luftës të SHBA-së është në finalizim e sipër, Kryeministri në detyrë

Kurti tha se bashkëpunimi në këtë fushë ndërmjet dy vendeve është më i fortë se kurrë.

Në fund të bisedës, kryeministri në detyrë Kurti dhe katër kongresistët u dakorduan të vazhdojnë bashkëpunimin e ngushtë në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, në përputhje me vlerat e përbashkëta të Kosovës dhe SHBA-së.

OEK-u hap zyrën e parë të diasporës në Shtutgart

PRISHTINË, 22 MAJ - Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) ka hapur zyrtarisht zyrën e parë të diasporës në Shtutgart të Gjermanisë, një hap i rëndësishëm drejt forcimit të bashkëpunimit ekonomik me mërgatën shqiptare.

Ky projekt synon të lidhë më afër diasporën me ekonominë e Kosovës, duke krijuar mundësi të reja për

investime, rrjetëzim biznesor dhe promovim të produkteve kosovare në tregjet ndërkombëtare.

Me këtë rast, kryetari i OEK-ut, Lulzim Rafuna, ka nënshkruar rregulloren për funksionimin e zyrave të diasporës dhe emëroi Ilir Syli si udhëheqës të zyrës në Shtutgart.

Zyra e re do të shërbejë si pikë kontakti për lehtësimin

e investimeve në Kosovë dhe nga diaspora; krijimin e bashkëpunimeve ndërmjet bizneseve vendore dhe atyre të diasporës; ofrimin e informatave mbi mundësitë investuese; promovimin e produkteve kosovare jashtë vendit.

Pas Shtutgartit, OEK-u planifikon zgjerimin e rrjetit edhe në Gjenevë, Vjenë dhe Romë.





NË PRAG TË ZGJEDHJEVE TË 7 QERSHORIT, QEVERIA NË DETYRË NDAN MJETE FINANCIARE PËR DISA KATEGORI

OPOZITA DHE SHOQËRIA CIVILE THONË SE KURTI PO BLEN VOTA

Qeveria në detyrë ka marrë vendim të ndajë nga 100 euro për fëmijët, pensionistët, studentët aktivë dhe punëtorët në sektorët privatë. Mbështetja prej 100 eurosh për pensionistët dhe fëmijët do të ekzekutohet në fillim të javës së ardhshme, ndërkaq për studentët dhe punëtorët e sektorit privat pritet të hapet aplikimi javën e ardhshme. Mbështetja prej 100 eurosh për punëtorët e sektorit privat dhe atë publik e që nuk paguhen nga buxheti i shtetit vlen për ata punëtorë me të ardhura mujore më pak se 1 000 euro

shtesave për lehonat. Ai tha se kishte premtuar se shtesat për lehonat do të jenë sa paga minimale, teksa akuzoi partitë që më herët kanë qeverisur se nuk kanë ndërmarrë asnjë masë për këtë kategori. “Sivjet nga korriku paga minimale bëhet 500 euro në muaj. E njësoj si vitin e kaluar, në këtë muaj po i rrisim shtesat për lehonat, nga 325.9 euro në muaj në 500 euro në muaj. Me fjalë të tjera, nuk po e presim korrikun, por po e bëjmë qysh tani, nga ky muaj”, tha Kurti.

Ekzekutivi paguan vlerën e pagës minimale për gjashtë muaj për lehonat e papuna, ndërkaq tre muaj për ato të punësuar, të cilat marrin edhe një pagesë sipas Ligjit të Punës.

Kurti paralajmëroi edhe një program për mbështetjen e grave, të quajtur Superpuna për gratë, që tha se parasheh pagesë “për gjashtë muaj të pagës minimale nëse ato rikthehen në tregun e punës”.

Këto vendime vijnë 16 ditë para mbajtjes së zgjedhjeve të reja parlamentare. Ngjashëm, qeveria Kurti kishte vepruar edhe në prag të zgjedhjeve paraprake, të mbajtura në dhjetor 2025, kur kishte ndarë nga 100 euro për pensionistët dhe studentët. Por, ndër vite, edhe ekzekutivët e

udhëhequra nga partitë e tjera kishin ndërmarrë vendime të ngjashme, sikurse rritja e pagave për sektorë të caktuar, në prag të cikleve zgjedhore.

Opozita dhe analistët: Kurti po e blen votën e qytetarëve

Lidhur me vendimin e qeverisë në detyrë për ndarjen e 100 eurove për disa kategori kanë reaguar nga opozita dhe shoqëria civile. Kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka reaguar ndaj vendimit të qeverisë në detyrë, duke theksuar se kjo është blerje votash, propagandë, fyerje, ofendime dhe kriza të njëpasnjëshme. “Çdo mjet i mundshëm për të qëndruar me çdo çmim në pushtet. Asnjë ide. Asnjë projekt. Asnjë punë. Kjo nuk është pako e inflacionit. Kjo është pako e tentimit për blerje vote. Një përpjekje e vonshme për të mbuluar dështimin qeverisës me paranë e vet qytetarëve. Një ofendim zgjedhor për dinjitetin dhe nevojat reale të njerëzve të vendit, të atyre që i lë si të parafundit në Evropë. Të parafundit! Populli i Kosovës nuk blihet. E ardhmja e tyre nuk është në shitje”, ka shkruar Abdixhiku në “Facebook”.

Ai ka thënë se Kosovës i duhet një kapitull i ri. “Një kapitull ku politikanët nuk kujtohen për qytetarët vetëm në prag zgjedhjesh. Ku mirëqenia nuk shpërndahet si favor elektoral, por ndërtohet si politikë e përhershme shtetërore. Ku pagat e dinjitetshme, mbështetja për familjet, zhvillimi ekonomik, investimet e mëdha e kujdesi për qytetarin nuk janë mjete për votë, por detyrim i Republikës. I një Republike që zhvillohet e s’pranoj të jetë në fund të Evropës!”, ka thënë ai.

Albert Krasniqi nga organizata Demokraci Plus e cilësoi si tentim “për blerjen votash”. “Shpërndarja e parave nga arka e shtetit në mes të procesit zgjedhor, tregon për shterpësinë e ideve të një pushteti që tenton të blejë votat e qytetarëve të vendit të dytë më të varfër në Evropë”, shkroi ai në “Facebook”.

Vëzhguesi i zhvillimeve politike, Dardan Sejdiu, shkroi në rrjetet sociale se të gjithë mundin e qytetarëve, me këtë vendim, Kurti “ua hodhi në tokë”. Ai tha se ky vendim, i marr në prag të zgjedhjeve të 7 qershorit, nuk është kujdes për qytetarin. “Kjo është blerje e votës me paratë e qytetarit”, shkroi ai në “Facebook”. Ndërkaq Artan Behrami, që

EPOKA E RE**Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 22 MAJ - Kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, ka prezantuar të premten Pakon për përbalje me inflacion 2.0, e cila tha se u pamundësua që të miratohej më herët nga Kuvendi, tashmë i shpërndarë, për shkak të “bllokimit nga blloku opozitar”. Pakoja u tha se arrinte shumën e 200 milionë eurove, ndërsa Kurti nuk bëri me dije nëse kjo që u miratua të premten ka po të njëjtën vlerë.

Kurti tha se pakoja përfshin mbështetje të njëhershme prej 100 eurosh për pensionistët, fëmijët, punëtorët e sektorit privat dhe studentët aktivë. Pensionistët dhe fëmijët do të mund t’i marrin këto para

nga java e ardhshme, ndërkaq po javën e ardhshme do të hapet edhe procedura e aplikimit për kategoritë e tjera. “Jemi të vetëdijshëm që në mungesë të buxhetit të rishikuar, i cili u bllokua nga blloku opozitar, kjo pako nuk i adreson të gjitha problemet e nevojat, por sadopak lehtëson barrën për secilën familje në vendin tonë. Sepse për dallim nga blloku opozitar, qeveria jonë kujdeset që dora e shtetit ta prekë secilin”, tha Kurti.

Ministri në detyrë i Financave, Hekuran Murati, sqaroi se punëtorët e sektorit privat që mund të përfitojnë nga 100 euro janë ata që e kanë pagën më të ulët se 1 000 euro.

Në mbledhjen e ekzekutivit në detyrë, të mbajtur mëngjesin e 22 majit, Kurti njoftoi edhe për rritjen e

PËRKUJTOHEN TË RËNËT NË MASAKRËN E DUBRAVËS: SHTETI SERB VEPROI SI APARAT VRASËS

PRISHTINË, 22 MAJ - Të premtën janë përkujtuar viktimat e masakrës në burgun e Dubravës. Në 27-vjetorin e kësaj masakre, në Dubravë janë mbledhur krerët e shtetit, përfaqësues të partive politike, familjarë të viktimave dhe ish-të burgosur politikë, për t'i përkujtuar të vrarët nga shteti serb.

Të gjithë ata që e kanë vizituar Dubravën kanë thënë se kjo masakër është kujtimi më i hidhur për shqiptarët. Gjatë homazheve dhe akademisë përkujtimore, e cila është drejtuar nga i mbijetuari i masakrës së Dubravës, Sadik Zeqiri, është theksuar rëndësia e kujtesës dhe kërkesa për drejtësi për viktimat e kësaj masakre, ku janë vrarë 116 civilë shqiptarë.

Ushtruesja e detyrës së presidentes së Kosovës,

Albulena Haxhiu, ka përkujtuar viktimat dhe ka folur për përgjegjësinë historike dhe institucionale të kësaj ngjarjeje. “Në masakrën e Dubravës u vranë 116 shqiptarë. Në Dubravë shteti serb veproi si aparat vrasës. I kishte të burgosurit në regjistra, në pavijonin në rreshta nën urdhra dhe të mbyllur, kjo është arsyeja pse Dubrava ka peshë të veçantë juridike dhe morale”, ka thënë Haxhiu.

Ajo ka theksuar se krimi në Dubravë ka ndodhur për shkak të pranisë së strukturave shtetërore serbe. “Këtu krimi nuk ndodhi sepse shteti mungoi, ndodhi sepse shteti ishte i pranishëm në çdo hallkë, në komandë, në rojë, në mashtim dhe në përpjekje për ta fshehur të vërtetën”, ka thënë ajo, duke shtuar se masakra e Dubravës duhet të trajtohet si



dëshmi e krimeve të kryera në Kosovë.

Ndërsa kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ka thënë se masakra në burgun e Dubravës ka qenë krim kundër njerëzimit. “Emrat e viktimave të Dubravës të gdhendur në memorial janë

aktakuzë e përhershme e atyre që urdhëruan, organizuan dhe ekzekutuan këtë krim”, ka thënë Kurti.

Kurse i mbijetuari i masakrës së burgut të Dubravës, Nait Hasani, ka deklaruar se drejtësia për këtë ngjarje

tragjike është lënë pas dore dhe nuk është trajtuar siç duhet nga institucionet e Kosovës. Ai ka thënë se pavarësisht premtimeve të përsëritura ndër vite, nuk ka pasur hapa konkretë nga drejtësia apo institucionet shtetërore. “Shoqëria jonë nuk ka bërë mjaftueshëm për këtë masakër dhe për këtë burg, sepse nuk është trajtuar siç duhet. Nuk është marrë sa duhet nga gjykata, prokuroria dhe institucionet. Kemi ngritur zërin çdo vit dhe e kemi përjetuar këtë gjendje çdo vit. Kemi thënë se këtë vit do të bëjmë diçka, por çdo vit ka mbetur në heshtje nga institucionet e shtetit, nga drejtësia, Kuvendi, Qeveria dhe Presidenca. Dhe kur vjen puna për zgjedhje, sërish na kujtohet kjo çështje”, ka deklaruar Hasani.



mandatin e kaluar ishte deputet nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës, tha se Prokuroria “duhet të zbarkojë” në ekzekutiv, duke shtuar se kjo është “blerje klasike e votës, është ndikim i drejtpërdrejtë te votuesit”. Demokracia në Veprim vlerëson se vendimi i qeverisë në detyrë për ndarjen e pagesave të njehershme për kategori të ndryshme të qytetarëve, vetëm pak kohë para zgjedhjeve, përbën shkelje ligjore dhe rast klasik të keqpërdorimit të resurseve publike në periudhë zgjedhore. “Për më tepër, shpërndarja e pakove masive financiare krijon ndikim të drejtpërdrejtë në ambientin zgjedhor dhe cenon barazinë e garës ndërmjet subjekteve politike, duke krijuar

avantazh të padrejtë për partinë në pushtet. Legjislacioni zgjedhor qartazi ndalon përdorimin e resurseve publike për qëllime që ndikojnë ose mund të ndikojnë në vullnetin e votuesve. Ky parim vlen për secilën formë, përfshirë përdorimin e buxhetit të shtetit, por edhe përdorimin e automjeteve, zyrave dhe administratës publike gjatë fushatës – për të krijuar përfitime elektorale”, thuhet në reagimin e DnV-së.

DnV-ja rikujton që Kuvendi i Kosovës nuk kishte miratuar iniciativën për plotësim-ndryshimin e ligjit për buxhetin në kuadër të të cilit ishin paraparë mjete për një pako të tillë financiare. “Prandaj, në këtë drejtim ky vendim paraqet edhe

tejkallim të dispozitave të Ligjit për Qeverinë, i cili kufizon qartazi mandatin e një qeverie në detyrë në marrjen e vendimeve me implikime financiare, sidomos kur ato nuk burojnë nga planifikimi i rregullt vjetor dhe nga buxheti aktual. Kjo situatë bëhet edhe më problematike nga fakti që ndihma financiare shpërndahet në mënyrë të përgjithshme dhe pa ndonjë situatë emergjente të re që do të arsyetonte masa të tilla urgjente. Kjo e bën të vështirë ndarjen ndërmjet politikës sociale dhe ndërhyrjes elektorale, pasi që mbështetja për qytetarët duhet të ndërtohet përmes politikave të qëndrueshme, të planifikuara dhe të trajtuara përmes procedurave të rregullta

institucionale, e jo përmes vendimeve të improvizuara në prag të zgjedhjeve”, theksohet në reagim.

Demokracia në Veprim u bënë thirrje institucioneve që të përmbahen nga përdorimi i resurseve publike në funksion të fushatës dhe të respektojnë standardet ligjore dhe demokratike që garantojnë zgjedhje të lira dhe të ndershme. “Po ashtu, konsiderojmë se raste të tilla duhet të jenë subjekt i trajtimit institucional dhe juridik nga mekanizmat përgjegjës për mbrojtjen e integritetit dhe ligjshmërisë së procesit zgjedhor dhe administrimit të parasë publike. Mosveprimi ndaj praktikave të tilla rrezikon të normalizojë përdorimin e buxhetit të shtetit për përfitim politik gjatë

fushatave zgjedhore”, është theksuar në reagimin e DnV-së.

Të dhënat zyrtare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës flasin për inflacion prej 7.5 për qind në katërmujorin e parë të këtij viti. Ndërkaq, vitin 2025 Kosova e mbylli me inflacion prej 3.9 për qind.

Sipas Fondit Monetar Ndërkombëtar, aktiviteti ekonomik në Kosovë është ngadalësuar, ndërsa inflacioni është rritur gjatë vitit të fundit. Inflacioni i përgjithshëm arriti në 5.75 për qind në janar 2026, i nxitur kryesisht nga rritja e çmimeve të ushqimeve. Rritja reale e Prodhimit të Brendshëm Bruto u ngadalësua në 3.6 për qind në vitin 2025, nga 4.6 për qind në vitin 2024.

Në Spitalin e Pejës kryhet një operacion i rrallë

PEJË, 22 MAJ - Në një institucion shëndetësor publik është realizuar për herë të parë me sukses nefrektomia laparoskopike, një intervenim i rrallë dhe minimalisht invaziv, që konsiderohet hap i rëndësishëm drejt avancimit të kirurgjisë moderne. Sipas njoftimit të spitalit të

Pejës, ndërhyrja është kryer nga urologu dr. Shkëlzen Elezaj, ndërsa në realizimin e saj kanë marrë pjesë edhe ekipet e repartit të Urologjisë, Anestezionit dhe Kujdesit Intensiv. "Për herë të parë në një institucion shëndetësor publik është realizuar me sukses nefrektomia

laparoskopike, duke shënuar një hap të rëndësishëm drejt avancimit të kirurgjisë moderne dhe procedurave minimalisht invazive", thuhet në njoftim. Spitali ka shprehur mirënjohje për stafin e përfshirë në këtë procedurë, duke veçuar edhe kontributin e dr. Naim Loxhës

dhe dr. Liridon Elezajt. "Falënderim i veçantë për dr. Naim Loxha si dhe për dr. Liridon Elezaj për mbështetjen dhe bashkëpunimin profesional", thuhet më tej. Nga spitali theksohet se ky sukses është dëshmi e rritjes së kapaciteteve profesionale dhe



e zhvillimit të shërbimeve shëndetësore, duke nënvizuar se "me punë, dije dhe përkushtim, shëndetësia jonë vazhdon të ecë përpara".

NJË MUAJ PARABURGIM PËR SHTATË DREJTORËT E INSTITUCIONEVE SERBE NË KOSOVË

PRISHTINË, 22 MAJ - Gjykata Themelore në Prishtinë ka caktuar një muaj paraburgim ndaj shtatë drejtorëve të institucioneve arsimore dhe shëndetësore, që funksionojnë në Kosovë sipas sistemit të Serbisë, nën dyshimin se kanë ndikuar në vullnetin e lirë të votuesve.

Sipas njoftimit, masa e paraburgimit u është caktuar personave me inicialet M.D., B.P., Lj.K., M.D., N.R., B.L. dhe S.M., pasi ekziston rreziku real që të pandehurit, nëse lirohen në liri, teksa gjykata tha se ekziston rreziku real që nëse ata lihen në liri të arratisen me qëllim të fshehjes dhe ikjes nga përgjegjësia penale. Gjykata po ashtu tha se të pandehurit mund t'i përsërisin veprat penale nëse lihen në liri. Lista Serbe e dënoi këtë vendim, duke thënë se bëhet fjalë për "përndjekje dhe frikësim të serbëve dhe serbeve të ndershme".

Në njoftimin e lëshuar nga kjo parti thuhet se paraburgimi u është caktuar: Lubisha



Karaxhiq, drejtor i shkollës fillore "Milladin Mitiq" në Llapna Sellë; Boban Petroviq, drejtor i Shkollës së Mesme Elektroteknike në Sushicë; Millica Dimiq, drejtoreshë e shkollës fillore "Braça Aksiq" në Lipjan; Nebojsa Rashiç, drejtor i Shkollës së Mesme të Makinerisë në Preoc; Bratislav Llaziq, drejtor i Qendrës Klinike-Spitalore në Graçanicë; Mirjana Dimitrijeviq, drejtoreshë e Shtëpisë së Shëndetit në Graçanicë; Sasha Mlladenoviç, drejtor i Shtëpisë së Shëndetit në Gushtericën e

Ulët. "Në këto kohë të vështira duhet të tregojmë dinjitet, rezistencë dhe unitet kundër atyre për të cilët asgjë nuk është e shenjtë, dhe të cilët janë të gatshëm që për interesa personale dhe privilegje politike të godasin edhe popullin e tyre", tha Lista Serbe.

Lidhur me masën e paraburgimit të shqiptuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë pati reagime edhe në Serbi. Atje, ministri i Shëndetësisë, Zlatibor Lonçar, tha se ky vendim është i motivuar politikisht, si dhe duke theksuar se në mesin e shtatë të

arrestuarve janë tre drejtues të institucioneve shëndetësore në Kosovën qendrore.

Ndërkaq, Zyra për Kosovën në Qeverinë e Serbisë pretendoi se masa e paraburgimit u caktua "me urdhër të drejtpërdrejtë politik" të kryeministrit në detyrë të Kosovës, Albin Kurti, me ndihmën e Rashiçit.

Në reagim u tha se me këtë veprim po synohet "goditja e institucioneve serbe të shëndetësisë dhe arsimit, dobësimi i Listës Serbe dhe frikësimi i popullatës serbe para fillimit të fushatës zgjedhore".

Beogradi e cilësoi si "ndërhyrje të papranueshme" të Prishtinës në sistemin arsimor dhe shëndetësor serb në Kosovë. Kosova i vlerëson të paligjshme dhe paralele institucionet që funksionojnë sipas sistemit serb, dhe viteve të fundit i ka mbyllur ato, përveç institucioneve arsimore dhe shëndetësore.

Zyra për Kosovën në Qeverinë serbe tha po ashtu se Beogradi është në komunikim të vazhdueshëm me përfaqësuesit

ndërkombëtarë, duke kërkuar lirim të shtatë të arrestuarve.

Të dyshuarit u arrestuan më 19 maj me urdhër të Prokurorisë Themelore, e cila, siç është bërë e ditur, ka reaguar sipas detyrës zyrtare pas raportimeve mediale lidhur me pretendimet e liderit të Partisë për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë, Nenad Rashiç, se Lista Serbe po ushtron presion dhe po i shantazhon përkrahësit e tij.

Prokuroria ka bërë të ditur se personat e arrestuar dyshohet se kanë qenë të përfshirë në aktivitete të paligjshme që lidhen me veprën për veprën penale "Cenimi i përcaktimit të lirë të votuesve".

Rashiç, i cili është ministër në detyrë për Komunitete dhe Kthim në Qeverinë e Kosovës, fillimisht më 14 maj tha se rreth 20 persona që e mbështesin atë kanë marrë vendimin largim nga puna, ndërsa në të ardhmen pritet që edhe rreth 40 persona të tjerë të marrin vendim për largim nga puna vetëm në territorin e komunës së Graçanicës.

KOMUNAT BASHKOHEN PËR FORCIMIN E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

PRISHTINË, 22 MAJ - Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) organizoi në Prishtinë takim të Kolegjiumit të Drejtorëve Komunal për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, duke mbledhur përfaqësues të komunave, partnerë dhe organizata bashkëpunuese për të diskutuar prioritetet dhe sfidat në sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural. Në fokus të takimit ishte forcimi i bashkëpunimit

ndërkomunal dhe koordinimi i politikave lokale, ku AKK-ja prezantoi aktivitetet dhe prioritetet e saj në mbështetje të komunave dhe avancimit të qeverisjes lokale.

Pjesëmarrësit vlerësuan rëndësinë e kolegjiuemeve profesionale si mekanizma të rëndësishëm për shkëmbimin e përvojave dhe adresimin e sfidave të përbashkëta në nivel lokal dhe qendror.

Gjatë takimit u bë edhe



konstituimi i udhëheqjes së Kolegjiumit, ku kryesuese u zgjodh Jeta Rafuna, Drejtoreshë e Drejtorisë së Bujqësisë në Komunën e Prishtinës, ndërsa zëvendëskryesues Sylë Dukolli,

Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi, Pyltari dhe Zhvillim Rural në Komunën e Malishevës.

Një pjesë e rëndësishme e diskutimeve iu kushtua masave afirmative për subvencionet komunale në mbështetje të grave në bujqësi.

Në këtë kuadër, EcoKosWomen dhe Caritasi Zvicëran prezantuan iniciativat dhe aktivitetet në zhvillim për fuqizimin ekonomik të grave në zonat rurale, ndërsa Komuna e

Podujevës ndau përvoja konkrete nga zbatimi i politikave lokale në këtë drejtim.

Takimi u karakterizua nga diskutime konstruktive dhe frymë bashkëpunimi ndërmjet Komunave dhe partnerëve relevantë, me theks në nevojën për politika më efikase dhe mbështetje të qëndrueshme për zhvillimin e sektorit bujqësor dhe komuniteteve rurale në Kosovë.

Ekstradohet nga Gjermania për në Kosovë i kërkuesi me letër rreshtim ndërkombëtar

PRISHTINË, 22 MAJ - Policia e Kosovës, përkatësisht Drejtoria për Bashkëpunim Ndërkombëtar Policor, në koordinim dhe në bashkëpunim me njësitet tjera relevante të Policisë së Kosovës dhe institucionet e drejtësisë, me datën 21 maj 2026 ka bërë ekstradimin e shtetasit malazez nga

Gjermania për në Kosovë. I dyshuari ishte arrestuar nga autoritete gjermane, pasi që i njëjti kërkohet përmes INTERPOL-it me letër rreshtim ndërkombëtar, lëshuar nga institucionet e drejtësisë së Kosovës, për veprën penale 'vrasje e rëndë' dhe se i njëjti ishte shmangur drejtësisë.

Ekstradimi u realizua bazuar në ligjet në fuqi dhe në bashkëpunim të ngushtë në mes të institucioneve të Republikës së Kosovës dhe atyre gjermane.

I dyshuari, pas ekstradimit iu është dorëzuar njësiteve përkatëse të policisë për vazhdim me procedurat tjera ligjore.

Drejtorja për Bashkëpunim Ndërkombëtar Policor do të vazhdojë me shkëmbimin e informacioneve me institucionet vendore, shtetet dhe organizatat ndërkombëtare, me qëllim të parandalimit, hetimit dhe zbulimit të aktiviteteve kriminale që ndërlihen me hetimin e kryesve të veprave penale, si dhe aktivitete tjera në gjurmimin,



kapjen-arrestimin e personave dhe grupeve kriminale që veprojnë brenda dhe jashtë vendit.

Haxhiu takohet me shefin e AKI-së, diskutojnë për zhvillimet e aktuale të sigurisë në vend

PRISHTINË, 22 MAJ - Ushtruesja e detyrës së presidentes së Republikës së Kosovës, Albulena Haxhiu, ka pritur të premtën në takim drejtorin e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë (AKI), Petrit Ajeti, me të cilin ka njoftuar se ka biseduar për zhvillimet

aktuale të sigurisë në vend. "Biseduam për zhvillimet aktuale të sigurisë në vend, sfidat me të cilat përballet Republika dhe rëndësinë e funksionimit profesional, ligjor dhe të përgjegjshëm të institucioneve tona të sigurisë", ka thënë Haxhiu.

Presidentja Haxhiu ka thënë se siguria e Republikës së Kosovës kërkon përkushtim të vazhdueshëm, vigjilencë dhe punë të palodhshme çdo ditë shpesh larg syrit të publikut, por gjithmonë në shërbim të qytetarëve dhe shtetit tonë.



KQZ-ja CERTIFIKON LISTËN, 15,884 VOTUES MË SHUMË SE NË ZGJEDHJET E FUNDIT

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 22 MAJ - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) në mbledhjen e mbajtur në mënyrë elektronike mori vendim për certifikimin e Listës Votuese për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës, të cilat do të mbahen më 7 qershor 2026.

Sipas të dhënave nga kjo listë, numri i shtetasve të Kosovës me të drejtë vote në këtë proces zgjedhor është: 2,092,174 votues.

Kjo listë përmban 15,884 votues më shumë se në zgjedhjet e

parakohshme për Kuvend të cilat u mbajtën më 28 dhjetor 2025.

Sipas të dhënave nga Lista Votuese, numri i qytetarëve me të drejtë vote në vendvotime, në Republikën e Kosovës është 1,959,962 votues, ndërkaq numri i qytetarëve që janë regjistruar për të votuar jashtë Kosovës është 132,212 votues, prej të cilëve, 100,970 janë regjistruar për të dërguar fletëvotimin në kutinë postare jashtë Kosovës, 3,518 për të dërguar fletëvotimin në kutinë postare në Kosovë dhe 27,724 për të votuar fizikisht në përfaqësi diplomatike.

Procesi zgjedhor brenda vendit do të zhvillohet në 949 Qendra të Votimit, me gjithsej 2,550 vendvotime, prej të cilave 911 qendra me 2,498 vendvotime për votimin e rregullt dhe 38 qendra, nga një për çdo komunë, me 52 vendvotime për të mundësuar votimin me kusht.

Ndërkaq, procesi zgjedhor jashtë vendit, përveç votimit me postë, do të organizohet në 30 përfaqësi diplomatike, prej të cilave 17 ambasada dhe 13 konsullata, me gjithsej 47 vendvotime.

Votimi fizik në këto përfaqësi do të zhvillohet më 6 qershor.

HAMZA TAKOHET ME AMBASADORIN FRANCEZ, BISEDOJNË PËR ZHVILLIMET AKTUALE NË KOSOVË DHE ZGJEDHJET E 7 QERSHORIT

PRISHTINË, 22 MAJ - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Bedri Hamza, ka pritur në takim ambasadorin e Francës në Kosovë, Olivier Guerot, me të cilin ka diskutuar për zhvillimet aktuale në vend, si dhe për përgatitjet drejt zgjedhjeve të 7 qershorit.

Hamza ka thënë se në takim me ambasadorin francez ka rikonfirmuar angazhimin e PDK-së për një proces zgjedhor në përputhje me standardet më të larta demokratike. "Mirëprita sot në selinë e PDK-së ambasadorin e Francës në Kosovë, Olivier Guerot, me të cilin diskutuam për zhvillimet aktuale në vend, si dhe për përgatitjet drejt zgjedhjeve të 7 qershorit. Diskutuam edhe për nevojën që Kosova të tejkalojë klimën e krizave të vazhdueshme, të cilat kanë ndikuar negativisht në



gjendjen ekonomike dhe mirëqenien e familjeve kosovare. Rikonfirmova angazhimin e Partisë Demokratike të Kosovës për një proces zgjedhor në përputhje me standardet më të larta demokratike. E falënderova

ambasadorin Guerot për vizitën dhe për mbështetjen e vazhdueshme që Franca i ka dhënë Kosovës në rrugëtimin e saj demokratik dhe euroatlantik", ka shkruar Hamza në "Facebook".

Driton Hyseni emërohet zëvendësministër në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

PRISHTINË, 22 MAJ- Kryeministri në detyrë i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, ka emëruar Driton Hysenin në pozitën e zëvendësministrit në Ministrinë e Mjedisit dhe

Planifikimit Hapësinor.

Kryeministri në detyrë Kurti e uroi Hysenin për detyrën e re dhe i dëshiroi suksese në përmbushjen e përgjegjësisë të reja.



Konjufca takon homologun çek, diskutojnë për thellimin e bashkëpunimit mes dy vendeve

PRISHTINË, 22 MAJ - Zëvendëskryeministri i parë dhe ministri i Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Glauk Konjufca, zhvilloi një takim me zëvendëskryeministrin dhe ministrin e Punëve të Jashtme të Republikës Çeke, Petr Macinka, në Pragë.

Gjatë takimit u diskutua për thellimin e mëtejshëm të bashkëpunimit mes dy vendeve, rrugën e integritit evropian të Republikës së Kosovës si dhe prioritetet rajonale të përbashkëta. Takimi u zhvillua në përvjetorin e 18-të të

vendosjes së marrëdhënieve diplomatike mes Kosovës dhe Republikës Çeke.

Konjufca ka theksuar se Republika e Kosovës mbetet e përkushtuar për thellimin e mëtejshëm të marrëdhënieve me Republikën Çeke në fusha me interes të përbashkët



Ç'ËSHTË TREGU I PËRBASHKËT EVROPIAN DHE A MUND T'I BASHKOHET KOSOVA?

Kosova mund të jetë më pranë integritimit në Bashkimin Evropian, pas një iniciative të re që synon përfshirjen graduale të vendeve të Ballkanit Perëndimor në Tregun e Përbashkët Evropian. Mbështetja e Gjermanisë po shihet si sinjal serioz se BE-ja mund të kërkojë forma të reja afrimi për rajonin, edhe pa anëtarësim të plotë. Por, sa reale janë shanset që Kosova të bëhet pjesë e këtij tregu, dhe çfarë do të nënkuptonte kjo për vendin?

PRISHTINË, 22 MAJ - Kosova, dhe shtetet e tjera të Ballkanit Perëndimor, morën një lajm shpresëdhënës këtë javë, kur disa vende të Bashkimit Evropian (BE) dolën me një nismë për futjen e tyre në Tregun e Përbashkët Evropian, për t'i shtyrë përpara në rrugën e tyre drejt anëtarësimit të plotë në BE.

Çfarë e bën këtë nismë më serioze, sipas ekspertëve me të cilët foli Radio Evropa e Lirë, është gatishmëria e udhëheqësit të njërit prej vendeve kryesore të BE-së, kancelarit gjerman Friedrich Merz, për ta çuar përpara atë. Në një dokument jopublik, dërguar vendeve anëtare, Austria, Çekia, Italia, Sllovakia dhe Sllovenia propozuan që vendet e Ballkanit Perëndimor të futen gradualisht në Tregun e Përbashkët, duke besuar se kjo do ta ruante vrullin në procesin e zgjerimit të BE-së, dhe do t'i nxiste këto vende ta përshpejtojnë përbushjen e reformave.

Tregu i Përbashkët Evropian është hapësirë, e përbërë kryesisht nga 27 vende anëtare të BE-së, që mundëson lëvizjen e lirë të mallrave, shërbimeve, kapitalit dhe njerëzve, pa rregullore kufitare ose tarifa doganore.

Pse propozimi i përshatet Kosovës

Nuk dihet nëse ky propozim do ta gëzojë mbështetjen e tërë bllokut, por ai duket ta ketë përkrahjen e një udhëheqësi të rëndësishëm, si Merz i Gjermanisë.

Toby Vogel, analist në Këshillin për Demokratizimin e Politikave në Bruksel, thotë për Radion Evropa e Lirë se,



megjithëse propozime të tilla ka pasur edhe në të kaluarën, ky i tanishmi ka dy gjëra të reja me rëndësi: përparimi i Ukrainës në reforma dhe mbështetja e Merzit. "Pra, nëse shikoni vendet e Ballkanit Perëndimor, shumica e tyre kanë ngecur në aspektin e reformave të qeverisjes, sundimit të ligjit e kështu me radhë. Ukraina ka bërë përparim të madh", thekson Vogel.

Merz i ka dhënë "peshën e saj politike kësaj nisme", thotë Vogel, dhe "nëse Merz vërtet do ta shtyjë përpara këtë, atëherë për herë të parë në shumë vite, do të kishim një lloj mbështetësi të fortë, një kampion të zgjerimit brenda BE-së".

Në një letër drejtuar liderëve të BE-së, më 21 maj, Merz propozoi që vendet e Ballkanit Perëndimor të kenë qasje të privilegjuar në Tregun e Përbashkët, si dhe lidhje më të

ngushta me institucionet e BE-së në procesin e vendimmarrjes.

Ai propozoi t'u jepet atyre statusi i vëzhguesit në BE, ndërsa Ukrainës statusi i anëtares së asociuar, pa të drejtë vote, për të përshpejtuar procesin e anëtarësimit të plotë të tyre.

Kryenegociatori i Kosovës me BE-në, Jeton Zulfaj, nuk deshi të komentonte propozimet, kur u kontaktua nga Radio Evropa e Lirë.

Nga të gjitha gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, Shqipëria dhe Mali i Zi vlerësohet se kanë përparuar dukshëm në rrugën drejt anëtarësimit në BE, dhe janë në bisedime aktive. Serbia, Maqedonia e Veriut dhe Bosnja e Hercegovina kanë statusin e vendit kandidat.

Kjo e lë Kosovën si vendin e vetëm nga rajoni pa statusin e vendit kandidat, rreth katër vjet pasi aplikoi.

Vogel beson, tani për tani, se

për Kosovën një lloj integrimi gradual do të ishte më premtues sesa fillimi i procesit për anëtarësim të plotë, "i cili për momentin duket vërtet i pamundshëm, pasi nuk ka oreks nga ana e Komisionit Evropian për ta mbështetur atë".

Tregu i Përbashkët, sipas tij, mund të jetë interesant për Kosovën, por për të pasur ndonjë përparim, "BE-ja duhet të bëhet serioze".

Vogel thekson se integrimi gradual nuk do të kërkonte patjetër njohjen e Kosovës nga të gjitha vendet anëtare. "KE do të duhej t'u shpjegonte shteteve anëtare në një mënyrë të qartë dhe të fuqishme ligjrisht pse Kosova, edhe pse nuk njihet [nga Spanja, Greqia, Qiproja, Sllovakia dhe Rumania], mund të marrë pjesë në aspekte të tregut të brendshëm të BE-së", shton ai.

Vogel nënvizon se Kosova "ka miq në BE, por nuk ka miq që

janë të gatshëm të shpenzojnë kapital politik për të çuar përpara kërkesën e saj për anëtarësim".

Si do të përfitonte Kosova?

Përveçse do të siguronte qasje në një treg të madh evropian, ekonomia e Kosovës do të përfitonte edhe nga lehtësime procedurale dhe të komunikimit me autoritete të ndryshme të bllokut, thotë ekspertja kosovare e tregtisë, Sytrime Dervisholli, në një prononcim për Radion Evropa e Lirë.

Ajo thekson se, derisa ekonomia kosovare do të mundë të ndiente ndikim negativ fillimisht, për shkak se është industri e vogël prodhuese, "në plan afatgjatë, unë e shoh që do të jetë diçka pozitive për ekonominë e Kosovës dhe mbi të gjitha për konsumatorët tanë".

Ka disa sektorë të cilët do të përfitonin drejtpërdrejt, sipas Dervishollit, si sektori i mobilierisë, i ndërtimeve të parafabrikuara, i pijeve, i shërbimeve apo i teknologjisë së informacionit.

Ekonomia e vogël e Kosovës është e orientuar kryesisht nga konsumi, importet dhe remitancat e diasporës.

Sipas Fondit Monetar Ndërkombëtar, aktiviteti ekonomik në Kosovë është ngadalësuar, ndërsa inflacioni është rritur gjatë vitit të fundit. Inflacioni i përgjithshëm arriti në 5.75 për qind në janar 2026, i nxitur kryesisht nga rritja e çmimeve të ushqimeve.

Rritja reale e Prodhimit të Brendshëm Bruto u ngadalësua në 3.6 për qind në vitin 2025, nga 4.6 për qind në vitin 2024.

Vendimi i qeverisë hap rrugën për Zonën Industriale në Gjakovë

PRISHTINË, 22 MAJ - Në mbledhjen e Qeverisë së Kosovës të premtën është marrë vendim për nxjerrjen nga administrimi i Agjencisë Kosovare të Privatizimit të ish-ndërmarrjeve "Metaliku" dhe "Virxhinia", në Komunën e Gjakovës, si dhe transferimin e tyre tek Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit (MINTI).

Ministrja e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, Mimoza Kusari-Lila, ka theksuar se ky vendim hap rrugën për krijimin e Zonës

Industriale në Gjakovë, një projekt që është diskutuar për më shumë se një dekadë.

Sipas saj, me këtë hap po finalizohet një proces i gjatë institucional që synon shfrytëzimin e hapësirave ekzistuese për zhvillim industrial dhe krijimin e kushteve për investime të reja.

Ajo ka theksuar se brenda 100 ditëve të para të Qeverisë janë miratuar vendime të rëndësishme për dy komuna me potencial të madh industrial, Gjakovën dhe Gjilanin. "Jam

jashtëzakonisht e lumtur që, brenda 100 ditëve të para të Qeverisë, arritëm të kemi vendime të miratuara për Gjakovën dhe Gjilanin-dy komuna me potencial të madh për zhvillim industrial, kapacitete të reja prodhuese dhe qasje në tregje të reja rajonale dhe evropiane", ka deklaruar Kusari-Lila.

Sipas saj, këto vendime janë pjesë e një qasjeje më të gjerë për zhvillim ekonomik dhe rritje të mirëqenies së qytetarëve në gjithë vendin.



SI U LUHATËN TREGJET NGA DEKLARATAT E DONALD TRUMP



Deklaratat e përsëritura të presidentit amerikan Donald Trump lidhur me situatën mes Shteteve të Bashkuara dhe Iranit kanë krijuar një klimë të fortë pasigurie në tregjet ndërkombëtare financiare e energjetike, sidomos në tregun e naftës.

Sipas analizave të mediave ndërkombëtare, përfshirë The New York Times, lëvizjet e tregjeve janë bërë gjithnjë e më të ndjeshme ndaj çdo deklarate politike që vjen nga Shtëpia e Bardhë.

Trump ka alternuar mesazhet, mes atyre optimiste për negociata dhe deklaratave të forta për përshkallëzim ushtarak. Në disa dalje publike, ai ka theksuar se SHBA-të po "negocion me Iranin" dhe se ekziston mundësia e një marrëveshjeje për të kufizuar programin bërthamor të Teheranit.

Në të njëjtën kohë, ai ka deklaruar se Shtetet e Bashkuara kanë "kontroll të plotë" mbi situatën në rajon dhe se do të veprojnë në mënyrë të ashpër nëse Irani nuk pranon kushtet e vendosura nga Uashingtoni, përfshirë çështjet që lidhen me pasurimin e uranimit dhe sigurinë e rrugëve detare strategjike si Ngushtica e Hormuzit.

Këto deklarata kanë pasur ndikim të menjëhershëm në tregje. Kur Trump ka folur për përparim në negociata ose për shtyrje të sulmeve të mundshme, investitorët kanë reaguar me optimizëm, duke sjellë rënie të çmimit të naftës dhe rritje të tregjeve të aksioneve.

Në një rast të tillë, vetëm lajmi për një shtyrje të sulmeve të planifikuara nga Pentagoni ka bërë që çmimi i naftës të bjerë ndjeshëm brenda një dite, duke reflektuar pritshmëritë

për ulje tensionesh në Lindjen e Mesme.


Në të kundërt, kur deklaratat janë bërë më agresive dhe janë përmendur sulme të mundshme ose masa drastike ndaj infrastrukturës energjetike iraniane, tregjet kanë reaguar menjëherë me frikë dhe paqëndrueshmëri. Në këto momente, çmimet e naftës janë rritur ndjeshëm dhe bursat kanë shënuar luhatje të forta, duke reflektuar shqetësimin për një përshkallëzim të mundshëm ushtarak në rajon.

Sipas raportimeve, një rol të rëndësishëm në këtë situatë ka pasur edhe mënyra se si komunikohen vendimet politike, ku deklaratat publike të Trump shpesh kanë krijuar pritshmëri të ndryshme brenda një kohe shumë të shkurtër. Kjo ka bërë që tregjet të mos reagojnë vetëm ndaj veprimeve konkrete, por edhe ndaj fjalëve, postimeve në rrjete sociale dhe intervistave televizive.

Në disa raste, kur është përmendur mundësia e bllokimit ose hapjes së Ngushticës së Hormuzit, një nga pikat më strategjike të transportit të naftës në botë, tregjet kanë reaguar edhe më fort, pasi çdo ndërprerje në këtë zonë do të kishte ndikim global në furnizimin me energji. Kjo ka shtuar edhe më shumë ndjeshmërinë e investitorëve dhe spekulimet në tregjet e energjisë.

Për sa kohë që nuk ka një marrëveshje të qëndrueshme mes SHBA-ve dhe Iranit, dhe për sa kohë që deklaratat politike mbeten të paqëndrueshme, tregjet priten të vazhdojnë të reagojnë me luhatje të shpeshta dhe të forta.

Le parole di Trump



EURO GLASS
SAINT-DISAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Ronaldos i erdhi dita, shpallet kampion me Al-Nassrin

RIAD, 22 MAJ - Më në fund pritjes i erdhi fundi! Pas tre vitesh e gjysmë plot presion, kritika dhe pritshmëri të mëdha, Cristiano Ronaldo ka arritur të fitojë trofeun e parë me Al Nassrin, duke udhëhequr skuadrën drejt titullit kampion në Arabinë

Saudite për sezonin 2025/26. Verdhezinjtë kanë vulosur triumfin në javën e fundit të kampionatit, pasi kanë mposhtur bindshëm skuadrën e Damac me rezultat 4:1. Në mbrëmjen vendimtare të kampionatit ka shkëlqyer Ronaldo, i cili ka realizuar dy gola dhe ka

konfirmuar rolin e liderit në suksesin historik të ekipit duke shënuar kështu në tërësi 972 gola në karrierë. Në listën e golashënuesve janë regjistruar edhe Sadio Mane dhe Kingsley Coman, duke kompletuar festën e madhe të Al Nassrit. Skuadra nga Riadi e ka

mbyllur sezonin me 86 pikë, dy më shumë se rivalët e Al Hilalit, për t'u kurorëzuar kampione e Arabisë Saudite. Për Ronaldon, ky triumf përfaqëson një moment të shumëpritur dhe trofeun e parë që prej transferimit të tij te Al Nassr në fund të vitit 2022.



DUKAGJINI FITON PËR HERË TË PARË KUPËN E KOSOVËS

PRISHTINË, 22 MAJ - Dukagjini ka shkruar historinë duke e fituar për herë të parë Kupën e Kosovës në futboll. Skuadra nga Klina ka triumfuar 2:1 ndaj Ferizajt, në finalen e zhvilluar në stadiumin "Fadil Vokrri". Për Dukagjinin, ky ishte triumfi i parë në garën e kupës, pas tri finaleve të humbura në vitet 1995, 1996 dhe 2021.

Finalja ka dhuruar emocione, ritëm të lartë dhe supergola nga të dyja skuadrat. Dukagjini ka kaluar në epërsi në minutën e 16-të, kur Altin Mërlaku ka realizuar me një goditje të fuqishme nga distanca, duke mposhtur portierin McKenzie-Lyle.



Ferizaj ka reaguuar shpejt dhe ka barazuar rezultatin në minutën e 23-të me anë të Kushtrim Shabanit, i cili ka finalizuar saktë një aksion të organizuar mirë. Goli është konfirmuar pas rishikimit të VAR nga gjyqtari Genc Nuza.

Skuadra klinase ishte pranë golit të dytë edhe në pjesën e parë, kur Hekuran Berisha ka goditur shtyllën pas një depërtimi të gjatë individual. Në pjesën e dytë nuk kanë munguar tensionet. Në minutën e 70-të, Dukagjini ka

mbetur me një lojtar më pak pas përjashtimit të Erlis Xhemajlit me kartonin e dytë të verdhë.

Megjithatë, vetëm pesë minuta më vonë, Hekuran Berisha ka realizuar njërin prej golave më të bukur të finales. Sulmuesi 20-vjeçar ka shënuar nga gjysma e fushës, duke përfutur nga pozicionimi i avancuar i portierit kundërshtar për rezultatin 2:1.

Në minutat shtesë, Ferizaj ka kërkuar penalti me pretendim për prekje me dorë në zonë, por Nuza nuk ka vendosur për një gjë të tillë. Ky vendim ka shkaktuar reagime të shumta nga skuadra ferizajase.

Kapiteni Betim Haxhimusa është ndëshkuar me karton të kuq për protesta, ndërsa trajneri Arsim Abazi ka tërhequr ekipin nga fusha për disa minuta. Pas rikthimit në fushë, Ferizaj ka tentuar të shmangte humbjen, por rezultati ka mbetur i pandryshuar deri në fund. Në fund medaljet dhe trofeun për ekipin e Dukagjinit ia kanë ndarë presidenti i FFK-së, Agim Ademi dhe ministri në detyrë i Sportit, Blerim Gashani. Ky sukses i siguron Dukagjinit pjesëmarrjen në kualifikimet e UEFA Conference League për edicionin e ardhshëm.

ANGLIA PUBLIKON LISTËN PËR KUPËN E BOTËS, TUCHEL LË JASHTË PALMERIN, FODENIN DHE ARNOLDIN

LONDËR, 22 MAJ - Trajneri i Kombëtares së Anglisë, Thomas Tuchel, ka shpallur skuadrën e tij prej 26 lojtarësh për Kupën e Botës në Shtetet e Bashkuara, Kanada dhe Meksikë. Tuchel ka folur me të gjithë lojtarët përpara publikimit të listës, gjë që ka çuar në rrjedhje informacioni rreth një numri lojtarësh yje që janë lënë jashtë. Kështu pas publikimit të listës zyrtare është konfirmuar se Anglia do të jetë pa yje të tillë si Cole Palmer, Phil Foden dhe Trent Alexander-Arnold. Përveç tyre në listë nuk janë përfshirë as Harry Maguire dhe Luke Shaw, që kanë qenë senatorë të



ekipit kombëtar për shumë vite, teksa nuk janë ftuar as emra premtues si Adam Wharton dhe Levi Colwill. Trajneri i anglezëve, në një konferencë për medie ka pranuar se

momenti më i vështirë ishte t'u komunikonte lajmin lojtarëve që kanë mbetur jashtë listës finale. "Pati disa telefonata shumë të vështira, sepse i respektoj si futbollistë dhe si

njerëz. Të gjithë lojtarët në listën paraprake prej 55 emrash e meritonin një ftesë, por reduktimi i listës në 26 lojtarë ishte jashtëzakonisht i dhimbshëm", ka thënë Tuchel.

Lista e të ftuarve nga Tuchel:

Portierë: Jordan Pickford (Everton), Dean Henderson (Crystal Palace) dhe James Trafford (Manchester City).

Mbrojtës: Reece James (Chelsea), Ezri Konsa (Aston Villa), Jarell Quansah (Bayer Leverkusen), John Stones (Manchester City), Marc Guehi (Manchester City), Dan Burn

(Newcastle), Nico O'Reilly (Manchester City), Djed Spence (Tottenham) dhe Tino Livramento (Newcastle).

Mesfushorë: Declan Rice (Arsenal), Elliot Anderson (Nottingham Forest), Kobbie Mainoo (Manchester United), Jordan Henderson (Brentford), Morgan Rogers (Aston Villa), Jude Bellingham (Real Madrid) dhe Eberechi Eze (Arsenal).

Sulmes: Harry Kane (Bayern), Ivan Toney (Al Ahli), Ollie Watkins (Aston Villa), Bukayo Saka (Arsenal), Marcus Rashford (Barcelona), Anthony Gordon (Newcastle) dhe Noni Madueke (Arsenal).

Michael Carrick emërohet trajner me mandat të plotë te Man Unitedi

MANCHESTER, 22 MAJ - Michael Carrick është emëruar trajner i rregullt i Manchester Unitedit, pasi ka shkëlqyer në rolin e tij të përkohshëm në krye të klubit nga "Old Trafford". Carrick ishte emëruar trajner i përkohshëm në janar pas vendimit të Unitedit për t'u ndarë nga Ruben Amorim, dhe shpejt ka udhëhequr

klubin në një pozicion më të lartë në tabelën e Ligës Premier. Ai ka shijuar një ndeshje të parë ëndrrash, një fitore 2-0 ndaj rivalëve Manchester Cityt, dhe kjo është pasuar nga një fitore 3-2 jashtë fushe ndaj Arsenalit. Pas kësaj, ai gjithashtu ka drejtuar fitoret kundër Liverpoolit, Chelseas, Aston

Villës dhe Tottenhamit. Edhe pse rezultatet kundër klubeve me profil të ulët nuk kanë qenë aq mbresëlënëse, ai megjithatë e ka çuar Unitedin nga vendi i shtatë në të tretin dhe ka siguruar kualifikimin në Ligën e Kampionëve. "Manchester United është i kënaqur të njoftojë se Michael Carrick do të vazhdojë si

trajner kryesor i ekipit të parë të meshkujve, pasi ka nënshkruar një kontratë të re që do të zgjasë deri në vitin 2028", ka njoftuar Unitedi. Ky do të jetë roli i dytë i përhershëm i karrierës së tij si menaxher, pasi më parë ai ka kaluar tri vjet në krye të klubit të Championship, Middlesbrough.





Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Cje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “A&G Partners” Sh.P.K. me seli në Gjakovë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrB UNIK: 812296946 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “A&G Partners” D.O.O. od Gjakovica, donelo odluku o prestani rada sa nrB. 812296946 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “A&G Partners” L.L.C. with headquarters Gjakova, has come to the decision to quit its business: 812296946 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Liridon Isufi shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2.3.4 dhe diplomën e sh.m. mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.

- Hilmi Morina shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Jetulla Krasniqi shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën QK “11 Marsi” Prizren.

- Arjana Kukaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmU “Leke Dukagjini” Prizren.

- Sabit Ferati shpall te pavlefshme diplomën QK “11 Marsi” Prizren.

- Valentina Avdijaj nga Skivjani shpall të pavlefshme për herë të dytë diplomën e humbur dhe dëftesën e plotë të shkollës fillore “Ukshin Miftari”, Skivjan-Gjakovë.

- Çlirim Gjuraj nga Gërçina e Gjakovës, shpall të pavlefshme dëftesën e SH.F.M.U “7 Shtatori”, nga klasa e 6-9.

- Fitim Sylja shpall të pavlefshme 4 dëftesat si dhe diplomën e sh.m.h.t. “7 Shtatori” Prishtinë.

- Vilson Gjyckaj nga Novosella e Gjakovës shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të shkollës SH.F.M.U “Engjëll Gjoni”, Novosellë, nga klasa 1-8.

- Arta Salihi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11. të shkollës së mesme të mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.

- Albina Dinë Berdynaj shpall të pavlefshme diplomën e Universitetit “Fehmi Agani” Baçelor i Edukimit Fillor.

- Arta Salihi shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. “Selman Riza” Gjakovë nga kl 1-5 dhe 6-9.

- Salih Imeri shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12. dhe diplomën e gjmnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Veton Muhadri shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë si dhe dëftesat e kl. 10.11.12. - Beqir Cenaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën e Gjmnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Bedri Smolica shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Buna Sada shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10 të Gjmnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Abropa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992

